

# TË DREJTAT E MIA

LIBËR PËR NGJYROSJE





# TË DREJTAT E MIA

## LIBËR PËR NGJYROSJE

EMRI

MBIEMRI

KLASA

SHKOLLA


VENDI


Ky botim është realizuar në kuadër të projektit PROtectChild,  
i financuar nga Qeveria Suedeze.

Përgjegjësia për përmbajtjen qëndron tek zhvilluesi i saj.


Qeveria Suedeze jo domosdoshmerisht i ndan pikëpamjet dhe  
interpretimet e shprehura.

Para shumë vitesh diku në botë shumë njerëz të mirë të cilët i donin të gjithë fëmijët e botës dhe kujdeseshin për ta, u bashkuan që ti ndihmojnë fëmijët të jetojnë të shëndetshëm, të lumtur dhe të sigurtë. Kështu ata i shkruan disa rregulla për të drejtat e të gjithë fëmijëve, të cilat duhet t'i respektojë çdo vend i botës, edhe Kosova vendi ynë.






**Që të sigurohen që këto të drejta do t'i ketë çdo fëmijë, këta njerëz i shkruan këto rregulla në një libër të quajtur “Konventa e të drejtave të fëmijëve” dhe këtë libër e shpërndanë anë e mbanë botës.**



KONVENTA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE



**Qëllimi i këtyre rregullave është që të rriturit të kuptojnë se çfarë kemi nevojë ne që të rritemi të shëndetshëm të lumtur dhe të sigurtë.**









Nga foshnjë të vogla, ne rritemi ngadalë dhe trupi ynë ndryshon shpejt. Që të bëhemi të fortë ne kemi nevojë për ushqim të shëndetshëm, ujë të pijshëm dhe mjedis të pastër.

Ne kemi të drejtë për kushte që të jetojmë e të rritemi.






Njerëzit që i bënë këto rregulla e dinin që ne ende nuk mund të kujdesemi për veten tonë plotësisht, por këtë duhet ta bëjnë familjet tona dhe personat që kujdesen për ne. Ne duhet të marrim udhëzime, siguri dhe dashuri pasi që një ditë kur të jemi të rritur do të bëhemi qytetarë të sjellshëm, të përgjegjshëm dhe do të mund të kujdesemi për veten dhe të tjerët.





Ata që i krijuan këto të drejta, e dinin se fëmijët kanë mendje magjike andaj duhet që të gjithë tu ofrojnë lirinë që të shprehen. Ne kemi të drejtë që mendimet tona ti shprehim duke folur, shkruar apo duke vizatuar.





**Ne mund të mendojmë, vizatojmë,  
imagjinojmë dhe krijojmë!**

**Aftësitë tona duhet t'i zhvillojmë me mësim  
dhe aktivitete. Ne kemi të drejtë të shkojmë  
në shkollë dhe shkolla duhet t'i mbështesë  
personalitetet tona të veçanta, pa asnjë  
dallim.**








Kjo do të thotë se vendi ynë duhet tu ofrojë mbështetje, dhe mundësi edhe për fëmijët të cilët kanë aftësi më të veçanta pasi që ata janë unik dhe të barabartë me ne, por ju duhet më shumë dashuri dhe përkrahje nga vendi ynë dhe të gjithë ne, që ata të zhvillojnë aftësitë e tyre. Nëse ne nuk trajtohem mirë, duhet të mbrohemi nga vendi ynë.


Ne kemi të drejtë për mbrojtje dhe siguri.




**Loja është aktiviteti ynë i preferuar. Mjedisi ku ne rritemi duhet të na ofrojë mundësinë që të luajmë e të përjetojmë kënaqësi.**

**Ne kemi të drejtë të argëtohemi me gjërat që neve na pëlqejnë.**





Ne lindim me të drejtat tona, pa dallime se ku jetojmë, si dukemi apo si flasim. Por të kesh të drejta nuk do të thotë të bësh gjithmonë çfarë dëshiron. Të kesh të drejta do të thotë të mos provohesh nga asgjë që të kushtëzon fëmijërinë e lumtur, të sigurtë dhe të shëndetshme.





**Shëno dhe vizato të drejtën tënde këtu:**

**Unë kam të drejtë të...**





